



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 06.09.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 01.09.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Roza Komani B.I.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i shtratit të Lumit Krena “ , Nr. i prokurimit- 632-22-7920-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-22-082-511, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik Roza Komani B.I. e dt.01.09.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i shtratit të Lumit Krena “ , Nr. i prokurimit- 632-22-7920-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-22-082-511, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK –së, të datës 04.08.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.**
- 2. Përmirësohet pjesërisht DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË , i publikuar me datë: 04.08.2022;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëj përmirësimin e pjesërishtëm të Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Operatori Ekonomik **Roza Komani B.I.**, me dt.01.09.2022, ka parashtruar kërkesës për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i shtratit të Lumit Krena", Nr. i prokurimit- 632-22-7920-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-22-082-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 06.09.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të Kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik **Roza Komani B.I.**, të dt.01.09.2022, Autoriteti kontraktues, konstaton se pretendimet e Operatorit në fjalë, janë pjesërisht të bazuara, prandaj vendos që të bëj përmirësimin e pjesërishtëm e dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj
p.p.v: 
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

